

**AKT I THEMELIT**  
**DHE**  
**STAUTUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Qualiconsult Balkans” shpk**

Në Tiranë, sot më datë 10/03/ 2021, me cilesine e “ortakut themelues “Znj. Arsiola Kapri, madhor, me zotesi juridike dhe/ per te vepruar, identifikuar me dokumentin e identifikimit, nr. J35523074D, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, hartojmë aktet (Akt themelimi & Statut), për themelimin e *shoqerisë me përgjegjesi të kufizuar, me emërtimin “Qualiconsult Balkans” shpk.*

**KREU I**

**Neni 1**

**Krijimi**

Shoqëria “Qualiconsult Balkans” shpk, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqëria”).

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “Qualiconsult Balkans” shpk , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket, te cilet nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i Ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria e ka seline kryesore në: Rr. Teodor Keko, Zona G, Godina Nr.3/D2 Tirane.

Shoqëria mund te ndryshoje seline e tij, të hape zyra përfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Ortakut të vetëm.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarisë:**

Studim, projektim, mbikqyrje, kolaudim, konsulence, çertifikim per ndertimin dhe zbatimin e veprave ndertimore publike dhe private, objekte turistike, ushtarake, kulti, industriale, dhe te veprave te te gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar; restaurime, rikonstruksione. Studime urbanistike te te gjitha niveleve; planifikim urban; projektim arkitektonik; projektim strukturash mbajtese beton arme, metalike, druri; projektim rrugeshe te te gjitha niveleve, ura, tunele, nenkalime, autostrada, trase hekurudhore mbi dhe nen toke, portesh, aeroportesh, helikoportesh, projektim linjash dhe sisteme prodhimi dhe shperndarje energjie elektrike; linja nentokesore dhe mbitokesore per energjine dhe telekomunikacionet, centrale, projektim ujesjelles, kanalizime, vepra ujitjeje, vepra bonifikuese e ujore, vepra kullimi, impiante vaditese, diga; projektim vepra naftesjellose, gasjelles etj; Projektim fotogrametrik, hartografik, topografik, konsulenca tekniko – ekonomike sipas kategorive dhe nenkategorive profesionale dhe çdo lloj studimi dhe projektimi qe nuk permendet me siper. Studime fizibiliteti; Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim i



punimeve të ndërtimit dhe çertifikim i strukturave speciale. Studime në fushën e planifikimit urban. Shërbime ekspertize, lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe vlerësim të efikasitetit energjetic në ndërtesa. Shërbime konsulence, marketingu. Import - Eksport të produkteve, pajisjeve dhe makinerive që kanë lidhje me objektin e veprimtarisë. Energjia e rinovueshme.

#### Neni 5

#### Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

### **KREU II**

### **KAPITALI**

#### Neni 6

#### Kapitali themeltar

#### *Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 lek.

Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 1 kuote.

Kapitali i mësipërm do të zotërohet nga ortakët i vetëm i shoqërisë përkatësisht:

Arsiola Kapri, zotëruese i 1 kuote, që përfaqësojnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 100000 lekë .

Pjesët e kapitalit themeltar ,nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortakët, që pengohet të ushtrojë të drejtat, që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

#### Neni 7

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nepermjet emerimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut me të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare e Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

#### Neni 8

#### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;

*Arsiola Kapri*

c) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

## KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 9

##### Organi Vendimmarres

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 10

##### Administrimi

Administrator i shoqërisë është Znj. Arsiola Kapri.

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të asamblese së përgjithshme të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

#### Neni 11

##### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



d) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

dh) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) Administratori në respekt të dispozitave ligjore, mund të kryejë të gjitha operacionet që do të jnë të konsideruara nga administratori të nevojshme dhe të dobishme për të arritur objektivat sociale aty përfaqësohen të drejtat e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave të tretë.

f) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblesë së përgjithshme edhe në rastet kur :

Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim dhe

kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## Neni 12

### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## Neni 13

### Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

## Neni 14

### Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

*Aristo Kapur*

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe e ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### Neni 15

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, e ortakeve të shoqerise.

#### Neni 16

Prishja e shoqerise

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", dhe "dh", të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

#### Neni 17

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

*Ans'ida Kopris*

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së e ortakeve dhe administratorit.

### Neni 18

#### Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

### Neni 19

#### Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit, për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar.

### Neni 20

#### Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të këtij shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

### Neni 21

#### Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve të ligjit 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “ ndryshuar me ligjin 129/2104.

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë:

a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar pa kryerjen e likuidimit.

Neni 22  
Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të tij në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 23  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këto statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptarë.

Per sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 24  
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25  
Dispozita perfundimtare

Ky Statut i shoqërisë "Qualiconsult Balkans" shpk, u redaktua "ortaket" në 4 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

**"Qualiconsult Balkans" shpk**

Arsiola Kapri

